

## KOMENTAR

# Analiza Gjinore e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2025 me Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës

## Hyrje

Projektligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 u miratua nga Qeveria e Kosovës me datë 31 tetor 2024. Megjithatë, pas këtij miratimi, ky projektligj nuk u vu në dispozicion për konsultime publike në përputhje me [Rregulloren \(QRK\) Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës](#). Si rezultat, vetëm tani qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OShC) kanë pasur mundësinë të analizojnë buxhetin dhe të japin rekomandimet për të. Sipas [Ligjit për Barazi Gjinore](#) (LBGj), buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) përfshin integrimin gjinor në procesin buxhetor dhe “ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve” për të promovuar barazinë mes grave dhe burrave<sup>1</sup>. Integrimi gjinor përkufizohet si përfshirje e perspektivës gjinore në “planifikimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit, politikave, programeve dhe buxheteve, në të gjitha fushat politike, ekonomike dhe ato sociale”<sup>2</sup>. Ligji, kërkon që BPGj të përfshijë analizën gjinore për të adresuar nevojat e grave dhe burrave, duke informuar të gjitha shpenzimet publike, pasi që këto shpenzime financohen nga taksat e qytetarëve. BPGj duhet të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe praktikant më të mira ndërkombëtare, duke u mbështetur në LBGj, [Kornizën Suplementare për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore \(PEFA GRPFM\)](#), dhe [Objektivin 5.c.I të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara \(OZhQ\)](#). Bazuar në një analizë gjinore të projektbuxhetit për vitin 2025 të publikuar në faqen e internetit të parlamentit, ky komentari synon të informojë parlamentin në finalizimin e buxhetit 2025, duke përfshirë vëmendjen ndaj plotësimit të nevojave kyçe të grave, burrave, vajzave dhe djemve nëpërmjet shpenzimeve publike. Përderisa buxheti mund të ndikojë në barazinë gjinore në disa mënyra, prandaj BPGj duhet të zbatohet në të gjithë buxhetin, ky komentari thekson **katër** çështje thelbësore buxhetore që duhet të adresohen nga parlamenti drejt avancimit të barazisë gjinore.

## Përfshirja gjinore

Në përputhje me PEFA GRPFM dhe OZhQ 5.C.I, projektligji për Buxheti i Kosovës nuk përfshin anekse me perspektivë gjinore dhe nuk ka Deklaratë Gjinore në projektligjin për buxhetin. Pa këtë analizë gjinore, është e paqartë si buxheti kontribuon në barazinë gjinore. Buxheti i vitit 2025 nuk përfshin ndonjë analizë të nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, duke përfshirë burra dhe gra të moshave, etnive, aftësive dhe vendndodhjeve të ndryshme gjeografike. Prandaj është e vështirë të kuptohen nevojat e ndryshme që buxheti parashikon të adresojë dhe se si do të kontribuojë në avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore.

Një linjë e rëndësishme buxhetore e lidhur me barazinë gjinore ka të bëjë me financimin për Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGj), në shumën totale 380,230€ në vitin 2025, krahasuar me 368,912€ në vitin 2024 (është rritur për 3%) në kategorinë paga dhe shtesa, por nuk ka rritje të numrit të punëtorëve. Poashtu, pozita e një Zyrtari për Barazi Gjinore nën linjën për paga dhe mëditje në çdo komunë është e rëndësishme për alokimet e resurseve njerëzore për zbatimin e obligimeve në lidhje me rishikimet e politikave në nivel lokal nga perspektiva gjinore, ngritjen e njohurive për barazinë gjinore në nivel lokal, dhe zbatimin obligimeve tjera ligjore, në [Programin për Barazi Gjinore](#), edhe në planin e veprimit për barazi gjinore në nivel kombëtar dhe lokal. Linja buxhetore e emërtuar “Çështjet Gjinore” është në buxhetin e vetëm 45% e komunave. Kjo linjë specifike buxhetore është rritur (10%) në krahasim me vitin e kaluar. Një shumë mesatare 19,947€ është për komunë. Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës (38) duhet të alokojnë buxhet për çështje gjinore që i bie të ndahen 757,986€ nga buxheti i përgjithshëm shtetëror.

<sup>1</sup> Neni 3, paragrafi. 1.17.

<sup>2</sup> Neni 3, paragrafi. 1.16.

## Adresimi i dhunës me bazë gjinore

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2025 është rritur 67% buxheti për Shpenzimet Bazike për Strehimoret për dhunë në familje që janë 2,500,000€, buxheti për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave është 542,146€ është rritur 31% në krahasim me vitin e kaluar, rritja e buxhetit për këto dy linja buxhetor është një shembull i ndikimeve pozitive gjinore. Por janë shpenzimet shtesë që nuk janë në projektligj të parashikuara nga [Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje](#) (Konventa e Stambollit):

- Nuk ekziston buxheti për një Qendër të Krizave të Dhunimit, trajtim për të mbijetuarat e dhunës Seksuale.
- Lidhur me [Projektin Udhëzim Administrativ \(QRK\) - Nr. xx/2024 për Linjën Emergjente Telefonike Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjinore](#) dhe ne [Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#), në Projekt-buxheti është e paqartë se në cilën kategori të shpenzimeve janë vendosur linjat telefonike.
- Në bazë të [Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#) dhe ne përputhje me përgjegjësit institucionale brenda [Ligjit nr. 08/I-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave](#) të gjitha komunat duhet të ndajnë buxhet për Qendrat për Punë Sociale (QPS) në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve si pjesë e Grantit të Qeverisë për Shërbime Sociale për të punësuar dy punonjës social më shumë, të ngarkuar në mënyrë specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Këto pozita janë thelbësore për zbatimin e kuadrit të ri ligjor, parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e të mbijetuarve, kryesisht grave dhe fëmijëve. Në projektligjin për buxhet nuk është zbatuar ky obligim. Kostoja shtesë e punësimit të dy punonjësve social në secilën komunë për të trajtuar rastet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe atë në familje, do të arrinte në rreth 514,800€ në vit për Qeverinë e Kosovës, të llogaritura në bazë të pagës mesatare. Konkretisht, do të ishte 13,200€ për komunë për 37 komuna dhe 26,400€ për Prishtinën.
- Buxheti për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është rritur 5% krahasuar me vitin e kaluar por nuk ka rritje të numrit të burimeve njerëzore. Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të sigurojë që buxheti për burimet njerëzore të Avokatëve të Viktimave të mbulojë stafin e mjaftueshëm, kompensimin e drejtë dhe trajnimin e nevojshëm për të mbështetur në mënyrë efektive viktimat dhe për të promovuar barazinë gjinore. Aktualisht, nuk ka mjaft Avokatë të Viktimave për të përmbushur përgjegjësitë e tyre për të mbrojtur në mënyrë adekuate të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore.
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përmirësojë mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe të parandalojë përsëritjen e rasteve të dhunës me bazë gjinore duke ndarë fonde për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të monitorimit, përfshirë byzylykët elektronikë. Këto janë të rëndësishme për monitorimin e kryerësve të dhunës dhe për të siguruar që ata të respektojnë urdhrat e mbrojtjes, duke ofruar një shtesë shtesë sigurie për të mbijetuarit.

## Financimi adekuat i Skemës së Asistencës Personale

Buxheti i vitit 2025 nuk ka parasysh [pagën minimale dhe kohën aktuale që kërkohet nga asistentët personalë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara](#). Kjo kontribuon në shkeljen e të drejtave të punës së asistentëve personalë. Ekziston nevoja për të rritur buxhetin e alokuar për asistentë personalë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë (PTTP) me shumë aktuale prej 150€ dhe për personat e verbër me shumë aktuale prej 125€, të përputhet së paku me pagën minimale (që aktualisht është 350€) apo idealisht të përputhet me pagën mesatare (që është 521€). Asistentët personalë shpesh punojnë më shumë se tetë orë në ditë për të ofruar kujdes dhe nuk u paguhet pensioni. Kjo përbën shkelje të të drejtave të tyre të punës sipas Ligjit të Punës. Gratë priren të jenë të mbipërfaqësuar në mesin e asistentëve personalë, kështu që adresimi i këtyre çështjeve mund të kontribuojë në përmirësimin e jetesës së tyre dhe atyre për të cilët ata kujdesen. Duke marrë parasysh që në vitin 2024, kishte 3,021 persona PTTP dhe 1,849 persona të verbër, kjo do të kushtonte rreth 18,5€ milionë për vitin 2025

bazuar në pagë minimale, që është afërsisht dyfishi i shpenzimeve të vlerësuara aktuale. Ndërkaq, buxhetimi i bazuar në pagën mesatare bruto do të kushtonte përafërsisht 30.4€ milionë.

## **Financimi adekuat i shërbimeve të kujdesit**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të investojë drejtpërdrejt dhe të inkurajojë komunat të planifikojnë buxhet më të përballueshëm për krijimin e më shumë qendrave publike dhe kopshteve për kujdesin e fëmijëve. Duke [vendosur objektiva konkrete dhe alokime buxhetore bazuar në vlerësime të gjithanshme të nevojave, komunat mund të adresojnë nivelet e larta të papunësisë dhe pasivitetit](#). RrGK ka vlerësuar se zgjerimi i opsioneve të kujdesit ndaj fëmijëve mund të krijojë [afërsisht 9,899 vende të reja pune](#) në këtë fushë. Për më tepër, kjo do t'i mundësojë më shumë grave të punojnë dhe do të përmirësohen rezultatet arsimore në përputhje me [Objektivat e Barcelonës, BE](#). Duhet të planifikoj buxhet për rritjen e disponueshmërisë së [shërbimeve të përballueshme të kujdesit, veçanërisht në zonat rurale, është thelbësore për transformimin e punës së kujdestarisë së papaguar, në punësim të paguar, angazhimin e më shumë grave në tregun e punës dhe mbështetjen e një edukimi të përgjegjshëm gjinor që nga mosha e hershme](#). Sipas [Strategjisë Kombëtare për Zhvillim](#), Qeveria ka një detyrim ligjor për të realizuar këto investime, për të cilat tani duhen bërë alokimet buxhetore. Ndërsa Qeveria është mbështetur në donacionet ndërkombëtare për përmirësimin e disponueshmërisë së kujdesit për fëmijë, përfshirë fondet e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimin të Bashkimit Evropian (IPA), i bëjmë thirrje MASHTI-t të alokojë më shumë fonde të tilla dhe të inkurajojë fuqimisht komunat që të bëjnë të njëjtën gjë. Shpresojmë në uljen e varësisë nga financimet e jashtme për të siguruar burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme buxhetore për të ardhmen për këtë prioritet të rëndësishëm të zhvillimit kombëtar. Nuk është e qartë nëse ka rritje në projektbuxhet apo nëse mbetet i njëjtë.

## **Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës**

- **Çështjet Gjinore:** Sigurohuni që çdo komunë të ketë një buxhet në paga dhe mëditje për zyrtarin për barazi gjinore në mënyrë që ky person të mund të zbatojë detyrimet e tij ligjore.
- **Adresimi i dhunës me bazë gjinore:**
  - Ministria e Drejtësisë të alokojë burimet e duhura për një Qendër të Krizave të Dhunimit, të ofrojë trajtim për të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe një linjë telefonike SOS në përputhje me Konventën e Stambollit.
  - Të rritet buxheti i alokuar për QPS në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve për të punësuar dy punonjës social më shumë në secilën komunë, dhe katër në Prishtinë, të ngarkuar në mënyrë specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kostoja shtesë është rreth 514,800€.
  - Ministria e Punëve të Brendshme të përmirësojë mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe të parandalojë përsëritjen e rasteve të dhunës me bazë gjinore duke ndarë fonde për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të monitorimit.
- **Skemën e Asistencës Personale:** Të rritet linja buxhetore për financimin e Skemës së Asistencës Personale në bazën e kohës aktuale që kërkohet nga asistentët personal për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe të adresojë shkeljet e të drejtave të punës së asistentëve personal, që do të kushtonte rreth 18,5€ milionë për vitin 2025 bazuar në pagë minimale. Ndërkaq, buxhetimi i bazuar në pagën mesatare bruto do të kushtonte përafërsisht 30.4€ milionë.
- **Financimi adekuat i shërbimeve të kujdesit:** MASHTI dhe komunat të financojnë krijimin e qendrave të kujdesit për fëmijë për rritjen e punësimit dhe arsimimit të grave, duke siguruar mbështetje buxhetore të qëndrueshme dhe të pavarur nga donacionet.
- Qeveria të publikojë një Deklaratë Buxhetore Gjinore në përputhje me zotimet të PEFA dhe OZhQ 5.c.1., duke treguar se si buxheti do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore në Kosovë sipas zotimeve të Qeverisë.
- Qeveria që të publikojë online për transparencë të gjitha anekset buxhetore gjinore të kërkuara nga qarkoret buxhetore të cilat duhet të dorëzohen nga organizatat buxhetore.

**Ne, të nënshkruarit e mëposhtëm, mbështesim këto rekomandime dhe i bëjmë thirrje Parlamentit të Kosovës që t'i përfshijë ato në projektbuxhetin e vitit 2025 pa vonesë.**

Instituti GAP

Iniciativa Kosovare per Stabilitet

Instituti Riinvest

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) - Kosovë

Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Rrjeti i Grave të Kosovës (142 organizata për të drejtat e grave)

SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime

UN Women

Women for Women Kosovo